



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN

RAPORTI VJETOR 2019





QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN



RAPORTI VJETOR 2019

**RAPORTI I AKTIVITETEVE TË ZHVILLUARA
DHE PASQYRËS FINANCIARE**



JANAR, 2020

PËRMBAJTJA

HYRJJE

1. QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

- 1.1. Misioni
- 1.2. Vizioni
- 1.3. Detyrat

2. STRUKTURA

- 2.1. Drejtori
- 2.2. Këshilli i Botimeve për Diasporën
- 2.3. Struktura Administrative

3. RAPORTIMI I SEKTORIT TË DIGJITIMIT, KOMUNIKIMIT DHE PROJEKTEVE PËR VITIN 2019

- 3.1. Krijimi dhe mbarëvajtja e faqes web të QBD-së
- 3.2. Bashkëpunimi me institucionet brenda dhe jashtë vendit
- 3.3. Projekte
- 3.4. Aktivitete

4. RAPORTI I SEKTORIT TË BOTIMIT, KOORDINIMIT DHE SHPËRNDARJES PËR VITIN 2019

- 4.1. Sigurimi dhe shpërndarja e teksteve shkollore në Diasporë për vitin shkollor 2019 – 2020
 - 4.1.1. Sigurimi dhe shpërndarja e teksteve shkollore në diasporë për vitin shkollor 2019 – 2020
 - 4.1.2. Sigurimi dhe shpërndarja e teksteve shkollore shtesë në Diasporë për vitin shkollor 2019 – 2020
- 4.2. Sigurimi i literaturës plotësuese për vitin shkollor 2019 – 2020
- 4.3. Komisioni i Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën
- 4.4. Botime
 - 4.4.1. Fjalori dygjuhësh për fëmijë
 - 4.4.2. Seria “Klasikët dygjuhësh”
 - 4.4.3. Botime informuese
 - 4.4.4. Sponsorizimi i abetareve për fëmijët e Diasporës
- 4.5. Të dhënat e shkollave dhe mësuesve të gjuhës shqipe në Diasporë

5. RAPORTIMI I SEKTORIT TË FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

- 5.1. Buxheti i akorduar për vitin 2019
- 5.2. Buxheti i realizuar për vitin 2019
 - 5.2.1. Shpenzime korrente (602)
 - 5.2.2. Shpenzime Kapitale (231)
 - 5.2.3. Shpenzime Kapitale (231 rikonstruksion)
 - 5.2.4. Shpenzime për fondin e pagave dhe sigurimeve (600, 601)
- 5.3. Tabela e buxhetit dhe realizimi për vitin 2019
 - 5.3.1. Menaxhimi i financave
 - 5.3.2. Burimet njerëzore
 - 5.3.3. Protokolli
 - 5.3.4. Magazina
 - 5.3.5. Prokurimet

6. PLANI I PUNËS PËR VITIN 2020

A. PROJEKTE VJETORE

1. Hartimi i teksteve të reja të mësimdhënies për Diasporën përmes konkurrimit mbarëkombëtar;
2. Sigurimi dhe shpërndarja e teksteve shkollore për vitin 2020-2021
3. Sigurimi dhe shpërndarja e literaturës plotësuese për vitin 2020-2021
4. Hartimi dhe botimi i librave dygjuhësh për mësimdhënien në Diasporë
5. Hartimi dhe sigurimi i platformës digjitale të mësimdhënies në Diasporë

B. AKTIVITETE

1. Takimi mbarëkombëtar i Shkrimtarëve në Diasporë
2. Takimi mbarëkombëtar i Mësuesve në Diasporë
3. Biblioteka lëvizëse në Diasporë
4. Pjesëmarrje në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe aktivitete për mësimdhënien dhe letërsinë shqipe brenda dhe jashtë vendit.

SHTOJCA 1. AKTE TË KËSHILLIT KOORDINUES TË BOTIMEVE PËR DIASPORËN SIPAS MBLEDHJEVE
SHTOJCA 2. TREGUESI I LEGJISLACIONIT PËR VITIN 2018-2019

1. QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Qendra e Botimeve për Diasporën është institucion i krijuar me VKM-në nr. 469, datë 26.07.2018, që financohet nga buxheti i shtetit dhe organizohet e funksionon në varësi të Ministrit të Shtetit për Diasporën.

1.1. MISIONI

Qendra e Botimeve për Diasporën ka për mision:

- Mbështetjen e mësimit të gjuhës shqipe;
- Njohjen dhe përhapjen e kulturës kombëtare në diasporë përmes botimit të teksteve shkolllore, botimit të librave me përmbajtje letrare, historike dhe sociale.
- Organizimin dhe mbështetjen e veprimtarive edukative, kulturore dhe sociale, që kanë për qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe dhe kulturës amtare në Diasporë.

1.2. VIZIONI

Qendra është në shërbim të misionit të ministrit të Shtetit për Diasporën në përfaqësimin dhe nxitjen e politikave të bashkëpunimit dhe të ndërveprimit me të gjithë shqiptarët, me qëllim fuqizimin dhe bashkëpunimin në të gjitha fushat me shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe shtetet ku ata banojnë.

1.3. DETYRAT

Detyrat e Qendrës së Botimeve për Diasporën janë:

1. Botimi dhe shpërndarja e teksteve mësimore të miratuara dhe literaturës plotësuese, të cilat do t'i shërbejnë mësimdhënies dhe ruajtjes së identitetit kombëtar në komunitetet shqiptare të Diasporës.
2. Përgatitja dhe zbatimi i projekteve dhe programeve për mësimin e gjuhës shqipe në distancë nëpërmjet internetit si dhe rrjeteve dhe kanaleve elektronike të komunikimit masiv.
3. Zhvillimi dhe ruajtja e identitetit kombëtar përmes mësimit të gjuhës, kulturës së prejardhjes si dhe njohjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore kombëtare.
4. Organizimi dhe mbështetja e veprimtarive dhe projekteve në ndihmë të përhapjes së gjuhës dhe kulturës amtare në diasporë.

2. STRUKTURA

Në përputhje me pikën 6 dhe 8 të VKM-së Nr. 469, datë 26.07.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën", Qendra e Botimeve për Diasporën drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori dhe pranë saj funksionon Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, si organ këshillimor e vendimmarrës për çështjet e botimeve për diasporën.

- Drejtori
- Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën

2.1. DREJTORI

Drejtori i Qendrës së Botimeve për Diasporën është autoriteti përgjegjës për drejtimin, organizimin dhe administrimin e veprimtarisë së QBD-së .

Drejtori e përfaqëson QBD-në në marrëdhënie me të tretët. Ai emërohet në detyrë nga ministri përgjegjës për Diasporën. Gjatë vitit 2019 këtë detyrë e ka ushtruar znj. Mimoza Hysa.

Drejtori raporton dhe përgjigjet përpara Ministrin të Shtetit për Diasporën për aktivitetin e QBD-së, në mënyrë periodike.

2.2. KËSHILLI KOORDINUES I BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Bazuar në VKM-në Nr. 469, datë 26.07.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën", pranë QBD-së funksionon Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, si organ këshillimor dhe vendimmarrës për çështjet e botimeve për diasporën.

Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën është organ kolegjal, i përbërë nga pesë anëtarë, i cili ka përfaqësues nga:

- Ministria përgjegjëse për punët e jashtme;
- Ministria përgjegjëse për arsimin;
- Ministria përgjegjëse për diasporën;
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë;
- Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë.

Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën ka këto kompetenca:

- a) Mbledh dhe shqyrton kërkesat vjetore për botime për diasporën si dhe shqyrton kërkesat e herëpashershme, të cilat mund të mos jenë parashikuar në kërkesat vjetore;
- b) Miraton programet e botimeve të QBD-së, në përputhje me dokumentet strategjike për marrëdhëniet me diasporën;
- c) Planifikon shpërndarjen e teksteve të botuara nga Qendra;
- ç) Merr vendime për çështje të tjera, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi;
- d) I propozon ministrit përgjegjës për diasporën botimin e teksteve të tjera;
- dh) I propozon ministrit përgjegjës për diasporën çmimet e shitjes së teksteve, të cilat vendosen duke respektuar dispozitat e ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, "Për librin në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe kategoritë që përfitojnë falas kopje të teksteve të botuara nga QBD-ja, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ky Këshill ka edhe kompetenca të tjera, në përputhje me ligjin, të ngarkuara nga ministri përgjegjës për diasporën ose nga drejtori i Qendrës.

Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën është i përbërë nga:

Biblioteka Kombëtare	Piro Misha (kryetar)
Ministri i Shtetit për Diasporën	Elona Bano (anëtare)
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Mira Hoxha (anëtare)
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Anila Ferizaj (anëtare)
Akademia e Shkencave	Floresha Dado (anëtare)

Në mbledhjet e parë të Këshillit Koordinues për Diasporën, me propozim të Ministrit të Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, Këshilli zgjodhi kryetar znj. Persida Asllani, drejtuese e Bibliotekës Kombëtare. Me propozim të drejtorit të Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Mimoza Hysa, Këshilli i Botimeve për Diasporën ka marrë këto vendime për vitin 2019:


- ▶ VENDIM nr. 1, datë 19.04.2019, "Për miratimin e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Koordinues të Qendrës së Botimeve për Diasporën".
- ▶ VENDIM nr. 2, datë 19.04.2019, "Për miratimin e listës së librave shtesë në ndihmesë të mësimin në Diasporë"
- ▶ VENDIM nr. 3, datë 05.07.2019, "Për miratimin e listës së teksteve shkollore për mësimin plotësues në Diasporë për vitin shkollor 2019-2020"
- ▶ VENDIM nr. 4, datë 03.09.2019, "Për miratimin e listës së librave shtesë në ndihmesë të mësimin në Diasporë"
- ▶ VENDIM nr. 5, datë 23.09.2019, "Për miratimin e listës së librave shtesë në ndihmesë të mësimin në Diasporë"
- ▶ VENDIM nr. 6, datë 07.11.2019, "Për miratimin e botimit të "Fjalorit dygjuhësh për fëmijë" në këto gjuhë: shqip-italisht, shqip-anglisht, shqip-greqisht, shqip-gjermanisht, shqip-frëngjisht, shqip-kroatisht, shqip-turqisht, shqip-ukrainisht, shqip-spanjisht.
- ▶ VENDIM nr. 7, datë 07.11.2019, "Për miratimin e serisë (kolanës) "Klasikët dygjuhësorë".
- ▶ VENDIM Nr. 8 datë 07.11.2019, 1.Miratimin e blerjes së të drejtës për akses në platformën on line të mësimin të **gjuhës shqipe për rreth 300 mësues në Diasporë;**

2.3. STRUKTURA ADMINISTRATIVE

Struktura e Qendrës së Botimeve për Diasporën është miratuar me urdhrin nr.76, datë 15. 04. 2019 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Botimeve për Diasporën". Sipas kësaj strukture të miratuar, QBD-ja është e përbërë nga 3 sektorë dhe një personel prej 15 punonjësish.

Bazuar në urdhrin Nr.76, datë 15. 04. 2019 të Kryeministrit, struktura dhe organika e QBD-së, është sipas tabelës së mëposhtme:

STRUKTURA E QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN



Sipas organizimit strukturor të miratuar, QBD-ja përbëhet nga 3 sektorë: Sektori i Digjitimit, Komunikimit dhe Projekteve, Sektori i Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes dhe Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Sektori i Digjitimit, Komunikimit dhe Projekteve është përgjegjës për:

- Krijimin, mirëmbajtjen dhe pasurimin e faqes on line të librave në formë elektronike;
- Krijimin ruajtjen dhe konsolidimin e marrëdhënieve të QBD-së;
- Hartimin dhe ndjekjen e projekteve të QBD-së.

Sektori i Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes është përgjegjës për:

- Ndjekjen e procesit të përzgjedhjes, miratimit, botimit, shpërndarjes së teksteve shkollore për Diasporën;
- Ndjekjen e punës së grupit të punës ndërinstitucional për miratimin e teksteve shkollore për diasporën;
- Ndjekjen e prokurimit të teksteve mësimore dhe shpërndarjen e tyre sipas kërkesave të diasporës;
- Mbajtjen e lidhjeve dhe hartimin e një bazë të dhënash të shkollave, qendrave mësimore, shoqatave të diasporës të interesuara për tekstet shkollore;
- Bashkërendimin e punës për shpërndarjen e teksteve shkollore për diasporën si dhe të botimeve të tjera që janë objekt i punës së QBD-së.

Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse është përgjegjës për:

- Kryerjen e të gjithë veprimtarive mbështetëse të QBD-së me qëllim plotësimin e misionit të saj.

QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN



RAPORTI VJETOR 2019

**SEKTORI I KOMUNIKIMIT,
DIGJITIMIT DHE PROJEKTEVE**



3. RAPORTIMI I SEKTORIT TË KOMUNIKIMIT, DIGJITIMIT DHE PROJEKTEVE PËR VITIN 2019

3.1. Krijimi dhe mbarëvajtja e faqes web të QBD-së

Qendra e Botimeve për Diasporën, si pjesë e strategjisë së saj për vendosjen e komunikimit me organizatat, shoqatat, grupet e interesit, qendrat kulturore dhe subjektet e interesuara të diasporës, gjatë vitit 2019 ka krijuar dhe menaxhuar portalin e saj zyrtar (www.qbd.gov.al). Rubrikat informuese mbi institucionin dhe hapësirat e tjera të natyrës informuese kulturore e arsimore për Diasporën, si: personalitete historike, autorë dhe mësues në diasporë janë përditësuar dhe plotësuar rregullisht.

Librat e digjitalizuar (e-book) që gjenden në portali tonë janë mundësuar nga Biblioteka publike "Marin Barleti", Shkodër (30 libra të digjitalizuar) dhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë (20 libra të digjitalizuar).

Në hartën e digjitalizuar janë pasqyruar shkollat shqipe dhe shpërndarja e tyre në diasporë. Në këtë hartë janë paraqitur 370 shkolla shqipe.

Kemi realizuar administrimin e pajisjeve dhe sistemeve të komunikimeve elektronike, kontrole periodike të pajisjeve fizike, si: kompjuter, printer, UPS etj. Janë realizuar përditësimet e sistemeve "Software" si Microsoft Windows, antivirus, instalimi dhe përditësimi i paketës Adobe (Indesign, Photoshop, Illustrator, Corel Draw) etj.

3.2. Bashkëpunimi me institucionet brenda dhe jashtë vendit

Gjatë periudhës gjashtëmujore të punës aktive të Institucionit tonë në zbatim të Misionit të sipërcituar, është bashkëpunuar ngushtësisht me **Ministrin e Shtetit për Diasporën** për përmbushjen e detyrave të caktuara dhe në zbatim të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën. Në zbatim të detyrave të Planit të Veprimit të sipërcituar është bashkëpunuar ngushtë gjithashtu me Institucionet e Diasporës: **Agjencinë Kombëtare të Diasporës, Fondin e Zhvillimit të Diasporës.**

- Është ndërtuar një marrëdhënie e ngushtë bashkëpunimi me **Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit** për ngritjen e Komisionit të përbashkët Shqipëri-Kosovë, për hartimin e regjistrit kombëtar të mësuesve në Diasporë, për përcaktimin e nevojave të teksteve dhe materialeve plotësuese për mësimdhënien në diasporë, për zgjerimin e hartës së shkollave, për sigurimin dhe konfirmimin e numrit të mësuesve dhe nxënësve të gjuhës shqipe në Diasporë.
- Është ndërtuar gjithashtu një marrëdhënie e ngushtë bashkëpunimi me **Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme** për vendosjen e kontakteve me shkollat shqipe, shoqatat kulturore dhe mësuesit në Diasporë, për sigurimin e kërkesave për tekste shkollore dhe literaturë plotësuese, si dhe për shpërndarjen brenda afatit të teksteve mësimore për vitin shkollor 2019-2020.
- Një marrëdhënie e ngushtë bashkëpunimi është vendosur dhe me **Ministrinë e Arsimit, Teknologjisë dhe Shkencës së Kosovës**, si partnerë të rëndësishëm në përmbushjen e detyrimit për hartimin e teksteve të reja për diasporën.
- Qendra e Botimeve për Diasporën ka lidhur marrëveshje me Postën Shqiptare me qëllim lehtësimin e dërgesës në kohë të teksteve për mësimdhënien në diasporë në vendet përkatëse, sipas kërkesave të bëra nga vetë mësuesit e gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare atje, për vitin shkollor 2019-2020. (Marrëveshja Nr. 264 Prot., dhe datë: 11.12.2019).

- Në funksion të mirëqeverisjes, krijimit të një sistemi të kontrollit të brendshëm efektiv me qëllim administrimin ligjor të aseteve operationale si dhe mbrojtjen e interesave financiare të njësisë publike kundrejt parregullsive apo veprimeve që çojnë në kryerjen e veprave penale është firmosur një marrëveshje bashkëpunimi nga Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me qëllim auditimin e brendshëm të Qendrës së Botimeve për Diasporën si institucion i varësisë (Marrëveshja Nr.5621/6 Prot., 02.12.2019).

QBD-ja gjithashtu u është përgjigjur kërkesave dhe nevojave të institucioneve të Diasporës, si: qendra kulturore, klube e shoqata dhe kërkesave individuale të anëtarëve të Diasporës në kohë reale.

E përqendruar në detyrën e saj për zhvillimin dhe ruajtjen e identitetit kombëtar përmes mësimin të gjuhës, kulturës së prejardhjes si dhe njohjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore kombëtare, Qendra e Botimeve për Diasporën veç të tjerash ka përgatitur e përcjellë informacion, përmes buletineve informative, lajmërimeve në rrjetet sociale dhe komunikimit të drejtpërdrejtë me publikun dhe të interesuarit në dobi të komunitetit të Diasporës dhe nevojave të tij. Në vijim të kësaj, ajo ka grumbulluar mjaft të dhëna nga organizatat shqiptare në diasporë për efekte statistikore dhe informimi, të dobishme për mbarëvajtjen e komunikimit e ndërveprimit.

3.3. Projekte

Projekti “Mbështetja dhe përhapja e mësimin të gjuhës shqipe në diasporën shqiptare”

Në kuadër të misionit të Qendrës së Botimeve për Diasporën që është mbështetja e mësimin të gjuhës shqipe, njohja dhe përhapja e kulturës kombëtare në diasporë përmes botimit të teksteve shkollore, botimit të librave me përmbajtje letrare, historike, sociale etj., si dhe organizimi dhe mbështetja e veprimtarive edukative, kulturore dhe sociale që kanë për qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kombëtar, në datën 13 qershor të vitit 2019 kemi aplikuar në projektin e financuar nga UNESCO. Qëllimi i këtij projekti është forcimi i bashkëpunimit të departamenteve të gjuhës shqipe në të gjithë botën duke krijuar kështu një rrjet katedrash dhe duke bërë shkëmbimin e njohurive. Rrjeti do të përfshijë një gamë të gjerë institucionesh direkt dhe indirekt, si dhe profesorë, shkrimtarë, përkthyes për të krijuar mundësi bashkëpunimi jo vetëm me njëri-tjetrin, por edhe me institucionet shtetërore. Ky bashkëpunim do të krijohet me ide të reja kulturore, gjuhësore dhe letrare për gjuhën shqipe dhe marrëdhëniet që janë krijuar bazuar në kulturat përkatëse.

Aktualisht, projekti e ka kaluar fazën e parë të kualifikimit dhe po punohet me fazën e dytë që është faza e fundit, e vlerësimit, që përfundon në janar 2020.

Projekti “DIASPORA ADRI-ROOTS - Zhvillimi i Ndërtimit përmes Lidhjeve Kulturore”

Qëllimi i qëllimi kryesor i projektit “ DIASPORA ADRI-ROOTS “ është forcimi i turizmit në diasporë midis qyteteve të Adriatikut përmes bashkëpunimit territorial, dhe krijimin e një strategjie të përbashkët ndërkuftare që thekson historinë dhe trashëgiminë vendore, turizmin kulturor dhe faktorë të tjerë thelbësore për zhvillimin e zonave strategjike të vendeve të origjinës.

Turizmi në diasporë gjithashtu do të kontribuonte në zhvillimin e potencialeve ekonomike të ekonomisë lokale, duke përmirësuar kushtet e punësimit dhe jetën e atyre popullsive që jetojnë në territoret e synuara. Po ashtu, vendet e interesuara do të ruheshin përmes promovimit të një lloj turizmi të qëndrueshëm, i cili është një faktor thelbësor në zhvillimin

e zonave urbane dhe rurale. Për të arritur këto objektiva, është thelbësore të zhvillohen disa aktivitete strategjike, si promovimi i fshatrave historikë, vendeve të arkeologjive dhe itinerareve kulturore në territoret e synuara dhe ndërgjegjësimi i palëve të interesuara të zonës së synuar dhe politikëbërësve lokalë për ekonominë dhe sociale avantazhe që mund të nxirren nga krijimi i një rrjeti ndërkufitar të turizmit në diasporë.

Udhëtimi i njerëzve të diasporës në vendet e tyre të origjinës - turizmi i diasporës - njihet mirë si një instrument për kërkimin dhe ruajtjen e rrënjëve të forta personale dhe lidhjen me trashëgiminë personale.

E veçanta e turizmit në diasporë është ndjenja e fortë e lidhjes me destinacionin, për shkak të lidhjeve personale, kulturore dhe historike.

Për shkak të atyre veçantive, turizmi i diasporës mund të jetë një aset në promovimin e një turizmi "të ngadaltë" bazuar në rrënjët, i cili kontribuon në valorizimin e fshatrave historikë, qyteteve të vjetra, vendeve arkeologjike, të cilat janë të përfshira në vendet e origjinës së diasporave në Shqipëri. dhe Mali i Zi.

Në këtë projekt Qendra e Botimeve për Diasporën është partnere me institucione ndërkombëtare dhe vendase.

Ky projekt është në fazë vlerësimi.

3.4. Aktivitete

Gjatë vitit 2019 aktivitetet e Qendrës së Botimeve për Diasporën kanë qenë të limituara, pasi Qendra e ka filluar veprimtarinë e saj në fund të muajit maj 2019.

Aktivitetet në të cilat ka marrë pjesë QBD-ja janë si më poshtë:

Selanik, Greqi, 17-20 maj

Qendra e Botimeve për Diasporën mori pjesë në Festivalin e Shumëgjuhësisë (Festival of Multilingualism Language), një aktivitet kulturor i përvitshëm me pjesëmarrës nga e gjithë Evropa. Ky aktivitet u zhvillua në mjediset e bashkisë së Selanikut synonte njohjen me rrjetin e grave, punën e bërë, si dhe çështje të tjera me qëllim mbështetjen e iniciativave të tyre në Greqi, forcimin e lidhjeve me vendin e origjinës dhe angazhimin e këtij rrjeti në projektet e ndryshme dedikuar Diasporës shqiptare. Gjatë kësaj pjesëmarrjeje Qendra e Botimeve për Diasporën u njoh me mësuesit e gjuhës e shqipe atje dhe problematikat e tyre të mësimdhënies.

QBD-ja qe pjesë e tryezës e rrumbullakët me pjesëmarrësit e panairit dhe e takimit me kryetarin e Bashkisë Selanik dhe organizatorët e panairit. Gjatë takimit të kryetarit të Bashkisë së Selanikut dhe drejtoreshës së kulturës dhe u hodh ideja e bashkëpunimit ndërkulturor në lëmin e gjuhësisë dhe më gjerë si dhe e organizimit të një takimi të përbashkët dygjuhësh në Tiranë.

Prizren, Kosovë, 31 korrik - 3 gusht

Qendra e Botimeve për Diasporën mori pjesë në Seminarin XV Mbarëkombëtar të Mësimimit Plotësues të Gjuhës Shqipe dhe Kulturës Shqiptare që u zhvillua në Prizren. Ky ishte viti i pesëmbëdhjetë i organizimit të këtij eventit kushtuar mësuesve shqiptarë në Diasporë.

Ky event ishte një organizim i përbashkët mes Komunës së Prizrenit, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë. Temë kryesore e këtij Seminari ishte mësimdhënia dhe kishte si qëllim shkëmbimin e përvojave të mësuesve dhe diskutimin për metodat më të përparuara të mësimdhënies në Diasporë.

Ky aktivitet kishte afërsisht 130 pjesëmarrës, mësimdhënës nga e gjithë Evropa, zëvendësministrin në detyrë të Arsimit të Kosovës, z. Hestet Sahiti, Kryetarin e Komunës së Prizrenit, z. Mytahir Haskuka dhe Ministren e Arsimit të Republikës së Shqipërisë, znj. Besa Shahini.

Në këtë aktivitet drejtoresha znj. Mimoza Hysa prezantoi politikat shtetërore në ndihmesë të mësimdhënies në Diasporë, vizionin, nismat, punën e bërë dhe hapat e ndërmarrë deri tani në ndihmesë të hartimit të teksteve të reja të përbashkëta për mësimdhënien në Diasporë, si dhe projektet e tjera të ndërmarra në shërbim të ruajtjes dhe përhapjes së gjuhës dhe kulturës shqiptare jashtë vendit.

Prishtinë, Kosovë, 19 gusht -30 gusht

Qendra e Botimeve për Diasporën mori pjesë në Seminarin XXXVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, i organizuar nga Fakulteti i Filologjisë së Universitetit të Prishtinës, në të cilin morën pjesë rreth 100 studentë vendas dhe të huaj, si dhe 40 ligjërues.

Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Mimoza Hysa, ishte gjithashtu e pranishme në këtë seminar për të diskutuar dhe vendosur kontaktet mes QBD-së dhe studiuesve të gjuhës dhe kulturës shqiptare në diasporë.

Uster, Zvicër, 15 shtator

Qendra e Botimeve për Diasporën u prezantua në panairin "Diaspora 2019" në Uster të Zvicrës. Ky aktivitet u realizua nën organizimin e shoqatës "Bashkimi", me praninë e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore të Shqipërisë dhe Kosovës, të shtëpive botuese vendase dhe shqiptare, si dhe të shkrimtarëve dhe mësuesve në Diasporë. E ftuar në këtë panair, Qendra e Botimeve për Diasporën prezantoi punën e saj të deritanishme, vizionin, misionin dhe projektet në proces.

Zyrih, Zvicër, 16 shtator

Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Mimoza Hysa, zhvilloi një takim në Konsullatën e Kosovës në Zyrih të Zvicrës me Udhëheqësin e Misionit/ Ministrin Këshilltar z. Sami Kastrati dhe me Konsullin/Këshilltare znj. Shukrije Ramadani, ku u diskutua rreth politikës së përbashkët për zgjerimin e shkollave shqipe në kantonin e Zyrihut dhe më gjerë, si dhe për një përpjekje të përbashkët për ruajtjen e gjuhës shqipe në brezin e ri të Diasporës shqiptare.

Tiranë, 28 shtator

Qendra e Botimeve për Diasporën mori pjesë në konferencën dyditore "Kërkimi shkencor në hapësirën mbarëshqiptare dhe roli i Diasporës shkencore" që u organizua nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe instituti Alb Shkenca me mbështetjen e ministrit të Shtetit për Diasporën.

Në kumtesën e saj "Gjuha shqipe në epokën digjitale", Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për

Diasporën, znj. Mimoza Hysa, pasi bëri një parashtrim të gjendjes së mësimin të gjuhës shqipe në Diasporë, e vuri theksin në gjetjen e mënyrave për motivimin e brezit të ri të diasporës për mësimin e gjuhës amtare, duke nënvizuar se përpos formimit të vetëdijes së përkatësisë etnike dhe identitetit, gjuha shqipe duhet të ofrojë edhe dobishmëri praktike për të rinjtë.

Zara, Kroaci, 3 tetor - 5 tetor 2019

Qendra e Botimeve për Diasporën mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të Albanologjisë "Symbiosis on the shores of the Adriatic Sea-Encounters and dialogues among cultures" organizuar nga revista "Shëjzat- The Pleiades" në bashkëpunim me Universitetin e Zadarit, Shoqatën Italiane të Studimeve të Europës Juglindore dhe me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë, që u mbajt në Zara të Kroacisë.

Qëllimi i takimit ishte promovimi i kërkimeve shkencore në lidhje me studimet shqiptare dhe ballkanike, si dhe stimulimi i mëtejshëm i aktiviteteve të Institutit për Studime Shqiptare "Shejzat-Pleiades" me rastin e botimit të rinovuar të revistës "Shejzat". E themeluar në vitin 1957 nga shkrimtari shqiptar Ernesto Koliqi në Romë, kjo revistë pushoi së botuari 40 vjet më parë.

Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Mimoza Hysa përcolli përshëndetjet e Ministrit të Shtetit për Diasporën në Konferencën Ndërkombëtare të Albanologjisë në Zarë.

Dyseldorf, Gjermani, 12 tetor -13 tetor

Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën mori pjesë në takimin e parë me anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës. Ky takim u mundësua nga anëtari i Këshillit Koordinues të Diasporës, z. Lazim Destani.

Gjatë këtij takimi anëtarët u njohën në mënyrë të detajuar me politikat shtetërore për Diasporën, të cilat janë hartuar dhe janë në zbatim, institucionet në varësi të Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe punën e tyre të deritanishme në mbështetjen e komuniteteve shqiptare në fushën e kulturës, biznesit dhe arsimit.

Në takim ishte i pranishëm edhe ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, i cili foli për rëndësinë që ka pasur formimi i Këshillit Koordinues të Diasporës, si një strukturë, e cila funksionon për herë të parë në shtetin shqiptar. Kjo strukturë është ngritur për krijimin e një bashkëpunimi më të afërt mes institucioneve shqiptare dhe komuniteteve në Diasporë, për t'u njohur me problematikat e tyre dhe për t'u ofruar mbështetje.

Takimi vijoi me fjalët përshëndetëse dhe prezantimin e Politikave shtetërore për Diasporën nga Drejtorja Ekzekutive e Fondit shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, znj. Joana Jaupllari, nga drejtorja e kabinetit të Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Mimoza Hysa.

Romë, Itali, 18 tetor

Qendra e Botimeve për Diasporën merr pjesë në Kuvendin European të shkëmbimit të përvojave të mira mbi projektin e "Words4link - shkrimtarja e mërgimtarëve për integrimin", një projekt i rëndësishëm ky pjesë e të cilit do të jenë shkrimtarët shqiptarë në emigracion dhe QBD-ja.


Ky projekt i financuar nga Komuniteti European synon të bashkojë në një rrjet të përbashkët shkrimtarë emigrantë të vendeve të ndryshme që shkruajnë në gjuhën italiane. Projekti synon t'i japë zë letërsisë së migracionit, veprave të tyre dhe shkëmbimit të përvojave. Në rrjetin e krijuar nga projekti bëjnë pjesë dhe shumë shkrimtarë shqiptarë që shkruajnë në gjuhën italiane.

QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN



RAPORT VJETOR 2019

**SEKTORI I BOTIMIT, KOORDINIMIT
DHE SHPËRNDARJES**



4. RAPORTI I SEKTORIT TË BOTIMIT, KOORDINIMIT DHE SHPËRNDARJES PËR VITIN 2019

4.1. Sigurimi dhe shpërndarja e teksteve shkollore në Diasporë për vitin shkollor 2019 – 2020

4.1.1. Sigurimi dhe shpërndarja e teksteve shkollore në Diasporë për vitin shkollor 2019 – 2020

Kërkesat për tekste shkollore në Diasporë për vitin shkollor 2019-2020, e dërguara në përfaqësitë diplomatike të Shqipërisë në vendet pritëse të Diasporës shqiptare dhe të përpunuara nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, erdhën në Qendrën e Botimeve për Diasporën me shkresat nr. 9045/1 Prot., datë 01.07.2019, nr. 9045/1 Prot., datë 02.07.2019 dhe nr. 10149 Prot., datë 10.07.2019.

Në kuadër të mbështetjes dhe nxitjes për mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe në përmbushje të misionit të Qendrës së Botimeve për Diasporën, Sektori i Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes organizoi punën për sigurimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore në Diasporë për vitin shkollor 2019-2020.

Me propozim të QBD-së, u mbledh Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, i cili mori Vendimin nr. 3, datë 5.07.2019, *“Për miratimin e listës së teksteve shkollore për mësimin plotësues në Diasporë për vitin shkollor 2019 -2020”* dhe ngarkoi QBD-në për zbatimin e këtij vendimi.

Qendra e Botimeve për Diasporën siguroi në kohë sasinë e kërkuar të teksteve (në total 10 993 tekste) dhe u kujdes që çdo tekst të ishte i pajisur me pullën hologramë të certifikimit të Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë dhe me logon e Qendrës së Botimeve për Diasporën, si dhe më pas i dërgoi ato në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme. Tekstet u sistemuan në pako të veçanta diplomatike për çdo shtet dhe u nisën drejt destinacioneve përkatëse.

Brenda muajit shtator 2019, Qendra e Botimeve për Diasporën, në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe Postën Shqiptare, përfundoi me sukses të gjitha dërgesat e teksteve shkollore falas për mësimdhënien në Diasporë, sipas kërkesave të përfaqësive diplomatike dhe konsullore jashtë vendit. U shpërndanë sipas kërkesave 4060 tekste në Greqi, 3645 tekste në Itali, 460 tekste në Slloveni, 60 në Republikën Çeke, 50 në Rumani, 1348 në SHBA, 130 në Belgjikë, 900 në Angli, 100 në Turqi, 60 në Kroaci, 180 në Poloni dhe Ukrainë.

Këto tekste u shpërndanë falas në përmbushje të VKM-së nr. 492, datë 10.7.2019, *“Për miratimin e çmimeve dhe kategorive që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën për vitin shkollor 2019 - 2020”*.

4.1.2. Sigurimi dhe shpërndarja e teksteve shkollore shtesë në Diasporë për vitin shkollor 2019 – 2020

Pas shpërndarjes së parë të teksteve shkollore, pranë Qendrës së Botimeve për Diasporën erdhën kërkesa të tjera shtesë për tekste nga shoqatat e mësuesve në Diasporë. Pasi u përpunuan të gjitha kërkesat e ardhura dhe në përpjekje për të plotësuar çdo kërkesë, në shkresën me nr. 205 Prot., datë 09.10.2019, *“Kërkesë për tekste mësimore shtesë”*, QBD-ja kërkoi bashkëpunimin e Ministrisë së Evropës dhe Punët e Jashtme për furnizimin me tekste në bazë të gjendjes së librave në magazinën e MEPJ-së.

Qendra e Botimeve për Diasporën, në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe Postën Shqiptare, përfundoi me sukses të gjitha dërgesat e teksteve shkollore shtesë jashtë vendit për mësimdhënien në Diasporë, sipas kërkesave të ardhura pranë saj. Në bazë të këtyre kërkesave u shpërndanë 91 tekste në Gjermani, 30 tekste në Itali, 68 tekste në Kanada, 261 tekste në Francë, 30 tekste në Austri, 40 tekste në Finlandë, 295 tekste në Norvegji dhe 50 tekste në shkollën e gjuhës shqipe në Madrid të Spanjës (në total 850 tekste).

Këto tekste do të shpërndahen falas në përmbushje të VKM-së nr. 723, datë 11.11.2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 492, datë 10.07.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e çmimeve dhe të kategorive që përfitojnë falas tekste të botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën”.

4.2. Sigurimi i literaturës plotësuese për vitin shkollor 2019 – 2020

Në zbatim të urdhrin nr. 14, datë 19.08.2019, të Ministrit të Shtetit për Diasporën, zotit Pandeli Majko, me qëllim përzgjedhjen e titujve të librave plotësues për arsimin në Diasporë, u ngrit grupi i punës, i cili përbëhej nga Znj. Fajzola Kolgjini (Caushaj), Përgjegjëse e Sektorit të Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes – Kryetare; Znj. Valbona Gjergo, Specialiste – Anëtare; Znj. Klara Shoshi, Specialiste – Anëtare.

Kriteret e marra parasysh nga grupi i punës për përzgjedhjen e teksteve ishin:

- Të jenë libra që ndihmojnë në mësimdhënien në Diasporë;
- Librat të parashikohen për fazën fillestare të mësimin, fazën e dytë të aftësimit dhe fazën e tretë të zgjerimit të njohurive në gjuhën shqipe; gjithashtu të jenë të përshtatshëm për grup-moshat: 5 – 9 vjeç, 9 – 11 vjeç dhe 11 – 14 vjeç;
- Të jenë libra sa më argëtues, meqenëse bëhet fjalë për një mësim plotësues dhe me dëshirë, për të ftuar dhe për të tërhequr sa më shumë fëmijë;
- Të jenë informues për Shqipërinë.

Në përzgjedhjen e librave janë konsultuar edhe mësues të gjuhës shqipe në Diasporë, të cilët dhanë sugjerimet e tyre lidhur me këta tituj.

Për miratimin e librave plotësues, u mbledh dy herë Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, duke konsultuar me kujdes propozimet e dhëna nga grupi i punës dhe duke sugjeruar tituj të tjerë të përshtatshëm për mësimin plotësues të gjuhës shqipe. Në secilën nga mbledhjet, Këshilli mori nga një Vendim për miratimin e listës së librave shtesë (Vendimin nr. 4, datë 03.09.2019, si dhe Vendimin nr. 5, datë 29.09.2019, “Për miratimin e listës së librave shtesë në ndihmesë të mësimin në Diasporë”), duke miratuar së fundmi listën prej 11 tituj librash shtesë në ndihmesë të mësimin të gjuhës shqipe në Diasporë dhe tirazhin prej 500 kopjesh gjithsej për secilin prej tyre. Në përcaktimin e këtij tirazhi iu referuam shkresës nr. 14451 Prot., datë 11.10.2019, “Dërgohet kërkesa e Lidhjes së Mësuesve Shqiptarë të Italisë” si dhe shkresës nr. 14701 Prot., datë 16.10.2019, “Dërgohet kërkesa e Lidhjes së Mësuesve Shqiptarë të Greqisë” të ardhura nga MEPJ-ja për 5500 tekste gjithsej.

Lista e teksteve si më poshtë:

A. Tekste për mësimin e alfabetit, fjalëve dhe shkronjave përmes lojës. Faza I (mosha 5 – 9 vjeç)

1. Luaj me shkronjat;
2. Shkronjat / Shkruaj, fshi, mëso;
3. Një hap drejt shkollës;
4. Një elefant elegant.

B. Aftësimi i mësimin të gjuhës. Faza II (mosha 9 – 11 vjeç)

5. Çufo dhe Bubi kaçurrel,
6. 50 përrallat më të bukura;
7. Di të luaj dhe të qesh – 150 gjëgjëza;
8. Fabulat e Ezopit.

C. Njohuri më të thelluara për gjuhën dhe për atdheun e origjinës. Faza III (mosha 11 – 14 vjeç)

9. Tregime të moçme shqiptare; 10. Princesha Argjiro; 11. Malli për Mëmëdhenë.

Këto tekste do të shpërndahen falas sipas VKM-së nr. 723, datë 11.11.2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 492, datë 10.07.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e çmimeve dhe të kategorive që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën”.

4.3. Komisioni i Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën

Në funksion të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës, si dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës “Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare”, datë 23.03.2015, u ngrit grupi i kurrikulës, që finalizoi “Kurrikulën e mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në Diasporë dhe Mërgatë”. Mbi bazën e kësaj kurrikule do të hartohen tekstet e përbashkëta shkollore për mësimin e gjuhës shqipe në Diasporë.

Në zbatim të kësaj marrëveshjeje u ngrit *Komisioni i Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën*. Pjesë e këtij komisioni janë përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Shqipërisë, si dhe nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë së Kosovës.

~ Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën, u mbledh për herë të parë në datë 22 maj 2019 në koordinimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën. Anëtarët e Komisionit zgjodhën kryetarin e Komisionit, z. Nuhi Gashi, përfaqësues i Kosovës. Në këtë mbledhje Komisioni vendosi edhe hartimin e rregullores së funksionimit të tij nga përfaqësuesit e Kosovës brenda dy javëve nga data e takimit.

~ Në datat 26 dhe 27 qershor 2019, Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën zhvilloi mbledhjen e dytë në Prishtinë, më qëllim planifikimin e punës për shpalljen e konkursit për hartimin dhe miratimin e teksteve mësimore për Diasporën. Në përfundim të kësaj mbledhjeje Komisioni vendosi që brenda vitit 2019 të shpallë konkursin për nivelin e parë për tekstet mësimore të përbashkëta për Diasporën. Gjatë kohës Komisioni do të përgatisë dokumentacionin për shpalljen e konkursit, duke filluar nga plotësimi i standardeve për tekstet për Diasporën. Komisioni hartoi dhe miratoi kalendarin e punës deri në miratimin përfundimtar të teksteve.

~ Më 22-23 korrik u zhvillua në Vlorë mbledhja e tretë e *Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën*. Në këtë mbledhje u diskutuan dhe u hartuan standardet për tekstet e përbashkëta për Diasporën.

4.4. Botime

Në kuadër të ruajtjes, zhvillimit dhe mësimit të gjuhës shqipe në Diasporë, redaksia e Qendrës së Botimeve për Diasporën ka planifikuar të botojë projektin e botimeve dygjuhëshe, që synojnë pasurimin e fjalorit të lexuesve të Diasporës me fjalë të reja në gjuhën shqipe, si dhe zotërimin dhe përdorimin e dy gjuhëve në të njëjtën kohë.

Pjesë e këtij projekti është botimi “*Fjalor dygjuhësh për fëmijë*” dhe seria me rrëfime “*Klasikët dygjuhësh*”.

4.4.1. Fjalori dygjuhësh për fëmijë

Fjalori dygjuhësh për fëmijë është konceptuar për fëmijë të moshës deri në 6 vjeç dhe shoqërohet me ilustrime të përzgjedhura me kujdes për të qartësuar dhe për të konkretizuar edhe më shumë fjalët, duke i bërë ato më të kuptueshme. Përzgjedhja është orientuar drejt fjalëve që hyjnë në përditshmërinë e fëmijëve nëpërmjet leximeve të ndryshme, programeve televizive, të folurit në familje etj.

Ky fjalor synon t’u japë fëmijëve të Diasporës një lëndë të pasur për të përmirësuar njohuritë e tyre në gjuhën shqipe.

Projekti i botimit të këtij fjalori iu paraqit Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën, i cili në Vendimin e tij nr. 6, datë 07.11.2019, miratoi botimin e tij në 9 gjuhë, përkatësisht: *shqip-italisht, shqip-anglisht, shqip-greqisht, shqip-frëngjisht, shqip-gjermanisht, shqip-kroatisht, shqip-spanjisht, shqip-turqisht dhe shqip-ukrainisht.*





4.4.2. Seria “Klasikët dygjuhësh”

Në serinë “Klasikët dygjuhësh” përfshihen titujt më të mirë të klasikëve të një jete, të ilustruar në mënyrë interesante, dhe ofrohet një mënyrë e thjeshtë për të mësuar gjuhën, duke kombinuar dy gjuhë në të njëjtin libër.

Seria “Klasikët dygjuhësh” e Shtëpisë Botuese spanjolle “LIBSA”, përmban 7 libra me lidhje speciale, me nga dy përralla apo vepra klasike për çdo libër (gjithsej 14 rrëfime të letërsisë për fëmijë).

Seria ka në përbërje rrëfenjat: 1. E bukura dhe Bisha – Ujku dhe 7 kecat; 2. Hirushja – Pinoku; 3. Libri i xhunglës – 3 derrkucët e vegjël; 4. Rosaku i shëmtuar – Kësulëkuqja; 5. Piter Pani – Bukuroshja e fjetur; 6. Sirena e vogël – Udhëtimet e Guliverit dhe 7. Ushtari prej plumbi – Borëbardha.




Projekti i botimit të serisë “Klasikët dygjuhësh” iu paraqit Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën, i cili në Vendimin e tij nr. 7, datë 07.11.2019, miratoi botimin e kësaj serie në 5 gjuhë (*shqip - italisht, shqip - anglisht, shqip - greqisht, shqip - gjermanisht, shqip - frëngjisht*).

4.4.3. Botime informuese

Redaksia e Qendrës së Botimeve për Diasporën ka botuar gjatë këtij viti “*Revistën informuese*” dhe një “*Udhëzues për mësimdhënien në Diasporë 2019*”.

- Revista informuese është realizuar në kuadrin e njoftimit të publikut dhe sidomos Diasporës shqiptare për misionin dhe detyrat e QBD-së, strukturën dhe mënyrën se si funksionon kjo Qendër. Revista është shpërndarë në çdo aktivitet ku ka marrë pjesë Qendra e Botimeve për Diasporën dhe synon të sjellë këtë institucion sa më pranë Diasporës.




- Qendra e Botimeve për Diasporën ka botuar dokumentin “Udhëzues për mësimdhënien në Diasporë 2019” si një material dhe një dokument informues mbi ndryshimet ligjore, aktet dhe shkresat me rëndësi në mbështetje të mësuesve dhe mësimdhënies në Diasporën shqiptare. Ai synon të paraqesë ecurinë e deritanishme të politikave shtetërore që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e statusit të shkollave shqipe dhe të mësuesve në Diasporë. Ky udhëzues është një tregues i bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve të përbashkëta për Diasporën nga Komisioni i Përbashkët ndërshtetëror, në zbatim të Marrëveshjes së Përbashkët mes institucioneve përgjegjëse të dy vendeve.



Në kuadër të promovimit të Qendrës në Diasporë dhe të afimit të informacionit rreth punës së kryer nga Qendra apo aktiviteteve që priten të zhvillohen janë përgatitur edhe materiale të ndryshme promovionale, si:

1. Kartolina, të cilat u realizuan në funksion të transmetimit të aktivitetit “Letra nga Diaspora”. U realizuan 10 modele kartolinash ku në secilën prej tyre paraqitej një shkrimtar shqiptar në Diasporë së bashku me një fragment të shkurtër të krijimtarisë së tij. Këto letra janë shpërndarë në aktivitetet ku Qendra ka marrë pjesë dhe shërbejnë për një njohje më të mirë të shkrimtarëve më të njohur shqiptarë jashtë atdheut.



2. Fletëpalosje informuese të QBD-së. Këto fletëpalosje përmbajnë një përshkrim të shkurtër të misionit dhe të synimeve kryesore të Qendrës së Botimeve për Diasporën, aktiviteteve të kryera prej saj dhe ato që priten të kryhen vitin tjetër së bashku me kontaktet e të dhëna të tjera të domosdoshme.



3. Posterët e realizuar për të informuar rreth aktiviteteve që priten të realizohen në datën 22 shkurt 2020 rreth takimit të shkrimtarëve të diasporës “Letra nga Diaspora” dhe në datën 14-15 mars 2020 për takimin mbarëkombëtar të mësuesve.



4.4.4. Sponsorizimi i abetareve për fëmijët e Diasporës

Në muajin nëntor 2019, Unioni Financiar Tiranë sh.a., sponsorizoi blerjen e 600 sete abetaresh për Qendrën e Botimeve për Diasporën, të cilat do t'u shpërndahen fëmijëve të Diasporës. Këto abetare janë përgatitur nga një grup specialistësh sipas programeve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Paketa përmban:

- **Tekstin bazë**, Abetare, i strukturuar me tri pjesë: *Paraabetare, Abetare, Pasabetare*;
- **Fletoren e modeluar**, ku nxënësit, sipas modelit, do të shkruajnë shkronjat e dorës;
- **Fletën e punës**, ku nxënësit do të ushtrohen për mësimin e shkronjave, kryesisht të shtypit dhe disa njohuri gramatikore;
- **Fjalorin e ilustruar** (shqip-anglisht, shqip-italisht, shqip-gjermanisht);
- **CD-në**, që si mjet audiovizual u shërben nxënësve për proceset e të dëgjuarit dhe të vëzhguarit;
- **Mozaikun me vjersha** për secilën shkronjë;
- **Librin e stërgjyshërve** (me poezi të rilindësve);
- **Udhëzuesin për mësuesit dhe prindërit**.

4.5. Të dhënat e shkollave dhe mësuesve të gjuhës shqipe në Diasporë

Për krijimin e databazës së të dhënave për shkollat shqipe dhe mësuesit në Diasporë u shfrytëzuan të dhënat e ardhura me shkresën zyrtare nr. 4483/3 Prot., datë 30.05.2019, nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë “*Mbi kërkesën për bashkëpunim*”. Këto të dhëna zyrtare u përpunuan dhe u sistemuan së bashku me të dhëna të tjera të grumbulluara nga Qendra e Botimeve për Diasporën në bazë të kontakteve të saj të vazhdueshme me Diasporën, në Seminarin XV të Prizrenit “*Për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë*”, si dhe të kërkesave të herëpashershme që mbërrijnë në Qendër për tekste.



Të dhënat për shkollat shqipe janë hedhur edhe në ueb, në një hartë të digjitalizuar për to. Databaza pasurohet dita-ditës dhe puna me të vijon. Kontakte të reja vendosen gjithnjë e më shumë.

QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN



RAPORTI VJETOR 2019

**SEKTOR I FINANCEVE
DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**




5. RAPORTIMI I SEKTORIT TË FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Qendra e Botimeve për Diasporën për realizimin e buxhetit për vitin 2019 është mbështetur në nevojat e domosdoshme të institucionit dhe në zbatimin e VKM së saj të formimit, VKM Nr. 469, datë 26.07.2018 “Për Krijimin, Organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”. Ky raporti përfshin gjithë vitin 2019 por kryesisht gjysmën e dytë të tij, pasi QBD-ja ka filluar funksionimin e saj me strukturë të plotë pas miratimit të Strukturës me urdhër të Kryeministrit, Nr. 76, datë 15.04.2019 “Për miratimin e Strukturës dhe organikës së Qendrës së Botimeve për Diasporën”.

Qendrës së Botimeve për Diasporën, në mbështetje të ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019” i është vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit shuma prej 56.500.000,00 lekë e detajuar si më poshtë:

- | | |
|--|--------------------|
| 1. Shpenzime personeli (paga dhe Sigurime) | 15.600.000,00 lekë |
| 2. Shpenzime korrente (mallra dhe Shërbime) | 24.900.000,00 lekë |
| 3. Shpenzime kapitale për pajisje zyre dhe investime | 16.000.000,00 lekë |




5.1. Buxheti i akorduar për vitin 2019

Qendra e Botimeve për Diasporën, duke ju referuar planit për zbatimin e politikave të veta dhe në mbështetje të ligjit “Për menaxhimin financiar të Buxhetit” ka zbatuar një menaxhim sa më efektiv dhe mirë menaxhim të Buxhetit të akorduar për të.

Në mbarim të vitit 2019 rezulton se shpenzimet efektivisht të realizuara prej saj janë:

Shpenzime Korrente (602)	16,950,099
Shpenzime Kapitale (231)	5,660,040
Shpenzime Kapitale (231 Rikonstruksion)	4,582,062
Paga dhe Sigurime 600/601	11,073,983



5.2. Buxheti i realizuar për vitin 2019

5.2.1. Shpenzime korrente (602)

Fondi i shpenzimeve korrente është realizuar me vlerën 16.950.099 lekë ose **68%** e fondit të planifikuar për 2019.

Ky fond zë një pjesë të rëndësishme të realizimit të buxhetit për vitin 2019 pasi janë kryer kryesisht shpenzimet si:

- Realizimi i blerjes së teksteve mësimore dhe shpërndarja e tyre në vendet ku ka përqendrim të komunitetit Shqiptar në Diasporë.
- Realizimi i shpenzimeve për udhëtime jashtë vendit, dieta, akomodime dhe transport.
- Realizimi i shpenzimeve për material promocionale, kancelari, dhe te tjera shpenzime operative për mirëfunksionimin e aktivitetit të Qendrës së Botimeve për Diasporën.
- Realizimi i shpërndarjes së teksteve shpeshë nëpërmjet Postës Shqiptare

5.2.2. Shpenzime Kapitale (231)

Fondi i shpenzimeve kapitale është realizuar me vlerën 5,660,040 lekë ose **51%** e fondit të planifikuar. Këto shpenzime ishin të planifikuara kryesisht për realizimin e zërave si më poshtë:

- Blerje pajisje zyresh dhe pajisje elektronike e telekomunikacioni, TIK (printerë, fotokopjues, kompjuterë, UPS, mobilje për zyrat)
- Blerje pajise skanimi profesional për libra dhe pajise audio vizuale (video projektor, sistem fonie dhe aparat fotografik)
- Blerje kondicionerësh, kasafortë dhe aktivë të tjera për mirëfunksionimin e punës në Qendrën e Botimeve për Diasporën.

5.2.3. Shpenzime Kapitale (231 rikonstruksion)

Fond i shpenzimeve kapitale për rikonstruksion është realizuar me vlerën 4,582,062 lekë ose **92 %** e fondit të planifikuar. Kjo procedurë u realizua nëpërmjet sistemit të prokurimit publik në kushtet e emergjencës pasi godina në administrim të Qendrës së Botimeve për Diasporën u klasifikua si e pabanueshme prej tërmetit të datës 21.09.2019, sipas akt ekspertizës së Institutit të ndërtimit nr. 431/1, datë 13.10.2019, protokolluar me tonën me nr. 187/3, datë 17.10.2019.

5.2.4. Shpenzime për fondin e pagave dhe sigurimeve (600, 601)

Qendra e Botimeve për Diasporën ka nisur punë me strukturë të plotë me Urdhërin e Kryeministrit, nr. 76, datë 15.04.2019 dhe menjëherë pas miratimit të Strukturës së saj ka nisur procesi i rekrutimit sipas VKM Nr. 469, datë 26.07.2019 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën” dhe Kodit të Punës.

Shpenzimet e realizuara për fondin e pagave dhe të sigurimeve shoqërore për vitin 2019 janë mbështetur të struktura dhe numri faktik i punonjësve të Qendrës së Botimeve për Diasporën si dhe duke nisur nga muaji Maj 2019, që janë bërë rekrutimet dhe emërimet përkatëse të punonjësve.

Konkretisht, janë shpenzuar **11.073.983,00** lekë ose **71%** e fondit të parashikuar për vitin 2019.

5.3. Tabela e buxhetit dhe realizimi për vitin 2019

Përshkrim	Buxheti i parashikuar	Buxheti i Realizuar	Në %
Shpenzime korrente (602)	24,900,000	16.950.099	0.68
Shpenzime kapitale (231)	11,000,000	5,660,040	0.51
Shpenzime kapitale (231 Rikonstruksion)	5,000,000	4,582,062	0.92
Paga dhe sigurime 600/601	15,600,000	11,073,983	0.71
BUXHETI TOTAL	56,500,000	38.266.184	0.68

Duke ju referuar kësaj tablele dhe faktit që Qendra e Botimeve për Diasporën e ka nisur në muajin Maj punën e saj efektive, duhet theksuar se ka arritur të realizojë një pjesë shumë të rëndësishme të planit të saj vjetor dhe përmbushjen e misionit të saj.

5.3.1. Menaxhimi i financave

Gjatë vitit 2019, Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ka evidentuar të gjitha shpenzimet e kryera në përputhje me regjistrin e parashikimeve dhe detajimit të brendshëm të buxhetit të akorduar. Të gjitha shpenzimet (në lekë dhe valutë) janë pasqyruar në ditarët përkatës, bankë, magazinë dhe arkë.

Në zbatim të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe Udhëzimin për zbatimin e tij, sektori i financës ka përgatitur dhe likuiduar brenda afateve të përcaktuara urdhër shpenzimet për faturat e mara nga realizimi i prokurimeve, pagesat e pagave, honorarët dhe dietat e punonjësve. Numri i urdhër shpenzimeve për vitin 2019 është 125.

Janë përgatitur dhe dërguar për ekzekutim brenda afatit listë pagesat për pagat dhe sigurimet shoqërore, shëndetësore të punonjësve. Raportimet në ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si dhe rakordimet me Degën e Thesarit janë ekzekutuar brenda afateve të lejuara.

5.3.2. Burimet njerëzore

Procesi i rekrutimit të burimeve njerëzore ka nisur direkt pas miratimit të strukturës me Urdhër të Kryeministrit Nr. 76, datë 15.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Botimeve për Diasporën”.

Qendra e Botimeve për Diasporën që prej formimit të saj ka pasur si filozofi udhëheqëse ngritjen e kapaciteteve solide të burimeve njerëzore dhe të një strukturë organike e cila do e mbështesë në punën e saj për realizimin e misionit dhe objektivave të vazhdueshme.

Personi përgjegjës për burimet njerëzore disponon dosjet e personelit dhe i menaxhon ato me korrektësi në përputhje me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.

5.3.3. Protokollin

Në bazë të ligjit nr. 9154/2003, “Për Arkivat”, është bërë pritja e dokumenteve të hyra në institucion dhe pajisja e tyre me kartelën shoqëruese, numrat e protokollit dhe përcjellja e tyre në sektorët përkatës për ndjekje dhe zbatim. E njëjta procedurë ligjore është ndjekur edhe për shkresat dalëse.

Personi përgjegjës për protokollin ka marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe është pajisur me certifikatën përkatëse për seminarin teoriko – praktik për krijimin, evidentimin, klasifikimin, shërbimin dhe ruajtjen e dokumenteve. Gjithashtu, në fund të vitit punonjësi i protokollit në bashkëpunim me sektorët përkatës bën klasifikimin e dokumenteve administrative sipas pasqyrës emërtuese të çeljes së dosjeve dhe mbështetur në organikën e institucionit.

5.3.4. Magazina

Në zbatim të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në magazinimin e artikujve është ndjekur dhe zbatuar ligji në fuqi duke shoqëruar çdo hyrje dhe dalje nga magazina me flet hyrjen dhe flet daljen përkatëse.

5.3.5. Prokurimet

Qendra e Botimeve për Diasporën në përmbushje të misionit të saj dhe duke ju referuar buxhetit të miratuar për vitin 2019, ka hartuar regjistrin e parashikimeve për prokurimet publike. Në zbatim të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Qendra e Botimeve për Diasporën për periudhës maj – dhjetor, janë kryer dhe realizuar me sukses procedurat e prokurimit publik, si “kancelari”, “blerje tekstesh shkollore për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë”, “blerje

aksesi on-line për mësimin e gjuhës shqipe”, “blerje pajisje zyrash”, “blerje pajisje elektronike, TIK”, “blerje pajisje audio vizuale dhe skaner për profesional për libra”, “riparime te dëmeve nga tërmeti”, “blerje kondicionerësh”, “printime materiale promocionale”, “blerje biletash transport ajror” si dhe prokurime te tjera qe i referohen regjistrit të prokurimeve publike të ngarkuar on-line në faqen zyrtare të APP. Në regjistrin e parashikimeve janë ngarkuar në total 30 zëra për prokurim, nga të cilët një është anuluar për arsye së Ministria e Financave dhe Ekonomisë tërhoqi fondet për “Blerje automjetesh për të gjitha institucionet”, një është i pezulluar për arsye se çështja ka shkuar në KPP, dy të tjerë nuk arritën të realizohen për shkak të gjendjes së emergjencës natyrore të shpallur nga Qeveria e Shtetit Shqiptar për tërmetin e datës 26.11.2019, VKM nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë” dhe 23 janë realizuar me sukses.



QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN



PLANI I PUNËS PËR VITIN 2020



6. PLANI I PUNËS PËR VITIN 2020

A. PROJEKTE VJETORE

1. Hartimi i teksteve të reja të mësimdhënies për Diasporën përmes konkurrimit mbarëkombëtar;

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 469, datë 26.07.2018, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën", pika 2/a, QBD-ja si përgjegjëse për botimin e teksteve shkollore për Diasporën, ka ndërmarrë dhe mbështetur ngritjen e Komisionit të Përbashkët Shqipëri – Kosovë për hartimin e teksteve të përbashkëta për Diasporën.

Për vitin 2020 synohet rishikimi dhe vijimi i punës së Komisionit të sipërcituar, për përmbushjen e objektivave të përcaktuara nga "Marrëveshja e bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë" firmosur më 25 mars 2015.

2. Sigurimi dhe shpërndarja e teksteve shkollore për vitin 2020 -2021

Sigurimi i kërkesave për tekste shkollore nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme brenda muajit qershor 2020; sigurimi i teksteve brenda muajit korrik dhe shpërndarja e tyre deri në shtator 2020.

Për vitin 2019 – 2020 sigurimi dhe shpërndarja e teksteve mësimore u realizua në dy faza:

- Në fazën e parë, në zbatim të VKM-së nr. 443, datë 26.06.2019, "Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë" u siguruan dhe shpërndanë 10 993 tekste mësimore në 12 shtete, përkatësisht në: Greqi, Itali, Slloveni, Republikën Çeke, Rumani, SHBA, Belgjikë, Angli, Turqi, Kroaci, Poloni dhe Ukrainë. Ky proces u përfundua brenda muajit shtator të vitit 2019;
- Në fazën e dytë, në zbatim të VKM-së nr.723, datë 11.11.2019, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 492, datë 10. 07. 2019 të këshillit të ministrave "për miratimin e çmimeve dhe kategorive që përfitojnë falas tekstet e botuara nga qendra e botimeve për diasporën për vitin shkollor 2019 – 2020" u siguruan dhe shpërndanë 727 tekste mësimore në 7 shtete, përkatësisht në: Itali, Gjermani, Francë, Austri, Kanada, Norvegji dhe Finlandë. Ky proces u përfundua brenda muajit dhjetor të vitit 2019.

3. Sigurimi dhe shpërndarja e literaturës plotësuese për vitin 2020 -2021

Literatura plotësuese e miratuar me Vendim të Këshillit Koordinues për Botimin pranë QBD-së, Nr. 5 datë 23.09.2019 do të sigurohet dhe shpërndahet brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2020;

4. Hartimi dhe botimi i librave dygjuhësh për mësimdhënien në Diasporë

- a. Botimi i **Fjalorit dygjuhësh** (shqip-italisht; shqip-anglisht; shqip-frengjisht; shqip-greqisht; shqip-gjermanisht; shqip-turqisht; shqip-ukrahinisht; shqip-spanjisht) është miratuar Vendim të Këshillit Koordinues për Botimin pranë QBD-së, Nr.6 datë 07.11.2019 dhe do të botohet brenda muajit shkurt 2020;
- b. Platforma dygjuhëshe në të cilin përfshihet botimi i **serisë me përralla klasike** (7 përralla) në dy gjuhë (shqip-italisht; shqip-anglisht; shqip-frengjisht; shqip-greqisht; shqip-gjermanisht; shqip-turqisht; shqip-ukrahinisht; shqip-spanjisht) është miratuar Vendim të Këshillit Koordinues për Botimin pranë QBD-së, Nr.6/1 datë 07.11.2019 dhe do të botohet brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2020;

5. Hartimi dhe sigurimi i platformës digjitale të mësimdhënies në Diasporë

Sigurimi i aksesit për mësuesit dhe shkollat në Diasporë në Platformën digjitale të mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare për vitin shkollor 2020-2021 është përmbyllur. Zbatimi do të nisë në janar të vitit 2020.

Përmes kësaj Platforme mësuesit do të kenë mundësi ndjekjeje të mësimëve audiovizuale të programit mësimor nëntëvjeçar të miratuar nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit.

B. AKTIVITETE

1. Takimi mbarëkombëtar i Shkrimtarëve në Diasporë

Takimi mbarëkombëtar i Shkrimtarëve do të zhvillohet në datën 22 shkurt 2020 në Tiranë, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës së Shqipërisë.

Ky takim, i konceptuar si kuvendim mes njerëzve të letrave brenda dhe jashtë vendit, do të bëjë bashkë autorë, përkthyes, gazetarë, kritikë dhe studiues nga Diaspora dhe Shqipëria.

Takimi do të evidentojë një komunitet të rëndësishëm që ruajnë dhe lëvrojnë gjuhën shqipe në mërgatë dhe njëkohësisht vendosin urat e komunikimit mes gjuhës shqipe dhe asaj të huaj. Shkrimtarë të njohur, të vlerësuar brenda dhe jashtë vendit do të diskutojnë rreth temës së Atdheut, gjuhës dhe kulturës shqiptare në krijimtarinë e tyre.



2. Takimi mbarëkombëtar i Mësuesve në Diasporë

Takimi mbarëkombëtar i Mësuesve në Diasporë do të zhvillohet në datë 14 mars në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Takimi ka për qëllim shkëmbimin e përvojave dhe dijeve në fushën e arsimit dhe mësimdhënies në Diasporë. Gjatë këtij aktiviteti do të paraqiten kumtesa me tema të ndryshme, që do të trajtojnë problematikën me tekstet dhe literaturat e përdorura në Diasporë, metodologjinë e mësimdhënies, teoritë e të nxënës për nxënës që jetojnë në diasporën shqiptare, sfidat me të cilat ballafaqohen mësuesit në shkollat e komunitetit shqiptar etj. Objektivi i këtij takimi është rritja e bashkëpunimit në fushën e mësimdhënies, si dhe rritja e ndërveprimit të komuniteteve shqiptare të mësuesve në Diasporë.



3. Biblioteka lëvizëse në Diasporë

Biblioteka lëvizëse është një projekt madhor që konsiston në ngritjen e një biblioteke me tekste bazë dhe literaturë plotësuese për Diasporën në vendet kryesore ku ka një përqendrim të shqiptarëve në Europë, si: Itali, Greqi, Gjermani, Francë dhe Kroaci. Biblioteka e ngritur në këto vende, e vendosur pranë qendrave apo shoqatave kulturore shqiptare, e pajisur me libra të siguruara nga QBD-ja, do të përbëjë vendin e takimit dhe organizimit të aktiviteteve në nxitje të mësimin dhe lëvrimin të gjuhës shqipe.

4. Pjesëmarrje në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe aktivitete për mësimdhënien dhe letërsinë shqipe brenda dhe jashtë vendit.

Qendra e Botimeve për Diasporën do të synojë praninë e saj në panairët kryesore ndërkombëtare me qëllim vendosjen e kontakteve dhe përditësimin me botimet më të mira në fushën e mësimdhënies apo të letërsisë për fëmijë. Kështu do të planifikohet pjesëmarrja në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Bolonja, Festivalin Multikulturor të Selanikut etj.

SHTOJCA 1

VENDIME TË KËSHILLIT TË BOTIMEVE PËR DIASPORËN SIPAS MBLEDHJEVE

VENDIM Nr. 1 datë 19.04.2019

Për

Miratimin e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Koordinues të Qendrës së Botimeve për Diasporën

Këshilli Koordinues i Qendrës së Botimeve për Diasporën, në mbështetje të ligjit Nr.8480, datë 27.5.1999 për "Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës dhe Enteve Publike", VKM, nr 469, datë 26.07.2018, "Për Krijimin, Organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën",

VENDOSI

1. Të miratojë Rregulloren e Këshillit Koordinues të Qendrës së Botimeve për Diasporën:
2. Ngarkohet Këshilli Koordinues dhe Drejtori i Qendrës së Botimeve për Diasporën të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT KOORDINUES

Znj. Persida Asllani

Kryetare

Znj. Elona Bano

Anëtare

Z. Andris Stastoli

Anëtar

Znj. Anila Ferizaj

Anëtare

Znj. Floresha Dado

Anëtare

VENDIM
Nr. 2 datë 19.04.2019

Për

**Miratimin e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Koordinues
të Qendrës së Botimeve për Diasporën**

Këshilli Koordinues i Qendrës së Botimeve për Diasporën, në mbështetje të ligjit Nr.8480, datë 27.5.1999 për "Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës dhe Enteve Publike", VKM, nr 469, datë 26.07.2018, "Për Krijimin, Organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën",

VENDOSI

1. Të miratojë sekretar të Këshillit Koordinues të Qendrës së Botimeve për Diasporën Zj. Elona Bano.
2. Ngarkohet Këshilli Koordinues dhe Drejtori i Qendrës së Botimeve për Diasporën të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT KOORDINUES

Znj. Persida Asllani

Kryetare

Znj. Elona Bano

Anëtare

Z. Andris Stastoli

Anëtar

Znj. Anila Ferizaj

Anëtare

Znj. Floresha Dado

Anëtare

VENDIM

Nr. 3 datë 05.07.2019

Për

**Miratimin e listës së teksteve shkollore për mësimin plotësues në Diasporë
për vitin shkollor 2019-2020**

Këshilli Koordinues i Qendrës së Botimeve për Diasporën, në mbështetje të Ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 për "Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", VKM nr.469, datë 26.07.2018, "Për Krijimin, Organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën",

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e teksteve shkollore për mësimin plotësues në Diasporë për vitin shkollor 2019-2020.
2. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT KOORDINUES

Znj. Persida Asllani

Kryetare

Znj. Elona Bano

Anëtare

Z. Andris Stastoli

Anëtar

Znj. Anila Ferizaj

Anëtare

Znj. Floresha Dado

Anëtare

VENDIM
Nr. 4 datë 03.09.2019

Për

Miratimin e listës së librave shtesë në ndihmesë të mësimit në Diasporë

Këshilli Koordinues i Qendrës së Botimeve për Diasporën, në mbështetje të ligjit Nr.8480, datë 27.5.1999 për "Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", VKM nr.469, datë 26.07.2018, "Për Krijimin, Organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën",

VENDOSI:

- 1. Të miratojë listën e librave shtesë në ndihmesë të mësimit në Diasporë.**
- 2. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT KOORDINUES

Piro Misha

Anëtarë

Znj Elona Bano

Anëtarë

Z.Andris Stasoli

Anëtarë

Znj Anila Ferizaj

Anëtarë

Znj Floresha Dado

Anëtarë

VENDIM

Nr. 5 datë 23.09.2019

Për

Miratimin e listës së librave shtesë në ndihmesë të mësimit në Diasporë

Këshilli Koordinues i Qendrës së Botimeve për Diasporën, në mbështetje të ligjit Nr.8480, datë 27.5.1999 për "Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", VKM nr.469, datë 26.07.2018, "Për Krijimin, Organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën",

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e librave shtesë në ndihmesë të mësimit në Diasporë.
2. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT KOORDINUES

Z. Piro Misha

Kryetar

Znj. Elona Bano

Anëtare

Znj. Mira Hoxha

Anëtar

Znj. Anila Ferizaj

Anëtare

Znj. Floresha Dado

Anëtare

VENDIM

Nr. 6 datë 07.11.2019

Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, në mbështetje të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, për "Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike" dhe VKM-së nr. 469, datë 26.07.2018, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën",

VENDOSI:

1.Miratimin e botimit të "Fjalorit dygjuhësh për fëmijë" në këto gjuhë:

shqip-italisht, shqip-anglisht, shqip-greqisht, shqip-gjermanisht, shqip-frëngjisht, shqip-kroatisht, shqip-turqisht, shqip-ukrainisht, shqip-spanjisht.

2.Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT KOORDINUES

Z. Piro Misha

Kryetar

Znj. Elona Bano

Anëtare

Znj. Mira Hoxha

Anëtar

Znj. Anila Ferizaj

Anëtare

Znj. Floresha Dado

Anëtare

VENDIM

Nr. 7 datë 07.11.2019

Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, në mbështetje të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, për "Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike" dhe VKM-së nr. 469, datë 26.07.2018, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën",

VENDOSI:

Miratimin e serisë (kolanës) "Klasikët dygjuhësorë" e shtëpisë botuese spanjolle "Libsa".
Seria ka në përbërje 7 libra me nga 2 rrëfenja për secilin libër si më poshtë:

1. E bukura dhe Bisha - Ujku dhe 7 kecat;
2. Hirushja - Pinoku;
3. Libri i xhunglës - 3 derrkucët e vegjël;
4. Rosaku i shëmtuar - Kësulëkuqja;
5. Piter Pani - Bukuroshja e fjetur;
6. Sirena e vogël - Udhëtimet e Guliverit;
7. Ushtari prej plumbi - Borëbardha.

1. "Klasikët dygjuhësorë" do të botohet në 5 gjuhë (shqip-italisht, shqip-anglisht, shqip-greqisht, shqip - gjermanisht, shqip - frëngjisht).
2. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT KOORDINUES

Z. Piro Misha

Kryetar

Znj. Elona Bano

Anëtare

Znj. Mira Hoxha

Anëtar

Znj. Anila Ferizaj

Anëtare

Znj. Floresha Dado

Anëtare

VENDIM

Nr. 8 datë 07.11.2019

Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, në mbështetje të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, për "Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike" dhe VKM-së nr. 469, datë 26.07.2018, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën",

1. Miratimin e blerjes së të drejtës për akses në platformën on line të mësimin të gjuhës shqipe për rreth 300 mësues në Diasporë;

2. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT KOORDINUES

Z. Piro Misha

Kryetar

Znj. Elona Bano

Anëtare

Znj. Mira Hoxha

Anëtar

Znj. Anila Ferizaj

Anëtare

Znj. Floresha Dado

Anëtare

**VENDIMET E KOMISIONIT TË PËRBASHKËT TË SHQIPËRISË
DHE KOSOVËS PËR MIRATIMIN E TEKSTEVE MËSIMORE
PËR DIASPORËN**

VENDIM

Nr. 1, datë 22.05. 2019

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT TË PUNËS SË KOMISIONIT
TË PËRBASHKËT PËR MIRATIMIN E TEKSTEVE PËR DIASPORËN**

Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve mësimore për diasporën, i krijuar në zbatim të marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë; Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës "Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë", e lidhur në Tiranë, më datë 23.03.2015:

VENDOSI

1. Të miratojë Kryetarin e Komisionit të përbashkët Z. Nuhi Gashi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarët

Znj Etleva Kondi

Z. Arbër Salihi

Znj. Shqipe Gashi-Ramadani

Z. Isni Kryeziu

Z. Valmir Gashi

Znj. Erida Koleci

Znj. Majlinda Hala

Znj. Evis Mastori

Znj. Anila Ferizaj

Anëtare

Anëtar

Anëtare

Anëtar

Anëtar

Anëtare

Anëtare

Anëtare

Anëtare

VENDIM
Nr. 2, datë 22.05. 2019

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT TË PUNËS SË KOMISIONIT TË
PËRBASHKËT PËR MIRATIMIN E TEKSTEVE PËR DIASPORËN

Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve mësimore për diasporën, i krijuar në zbatim të marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë; Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës “Për organizimin e përbashkët të mëimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, e lidhur në Tiranë, më datë 23.03.2015.

VENDOSI

1. Të miratojë formalizimin e Komisionit të përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve mësimore për Diasporën me urdhër ministri
2. Hartimin e një rregulloreje të Komisionit të përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve mësimore për Diasporën.
3. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Komisionit

Nuhi Gashi

Anëtarët

Znj Etleva Kondi

Anëtare

Z. Arbër Salihi

Anëtar

Znj. Shqipe Gashi-Ramadani

Anëtare

Z. Isni Kryeziu

Anëtar

Z. Valmir Gashi

Anëtar

Znj. Erida Koleci

Anëtare

Znj. Majlinda Hala

Anëtare

Znj. Evis Mastori

Anëtare

Znj. Anila Ferizaj

Anëtare

VENDIM

Nr. 3, datë 23.07. 2019

Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për koordinimin me qëllim miratimin e teksteve mësimore për diasporën, i krijuar në zbatim të Marrëveshjes së bashkëpunimit datë 23.03.2015 e lidhur në Tiranë, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë; Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës "Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë" si dhe Urdhrit të Ministrit të Shtetit për Diasporën, nr.12 datë 21.05.2019, Komisioni i Përbashkët për Miratimin e Teksteve për Diasporën, pasi diskutoi sipas rendit të ditës,

VENDOSI:

1. Shqyrtimin në parim të Rregullores së Komisionit dhe rishikimin dhe harmonizimin e saj;
2. Shpalljen e konkursit për nivelin e parë të tekstit të përbashkët për diasporën, jo më larg se data 1 nëntor 2019;
3. Përgatitjen e Draft-Standarteve për tekstet e diasporës brenda datës 23 korrik 2019, në mbledhjen e paracaktuar në Vlorë (21-23 Korrik 2019).
4. Përfundimin e dokumentacionit të konkursit për nivelin e parë të tekstit të përbashkët për diasporën brenda datës 15 tetor 2019;
5. Miratimin i dokumentacionit të konkursit për nivelin e parë të tekstit të përbashkët për diasporën nga Ministrat përgjegjës deri më 25 tetor 2019;
6. Mbylljen e aplikimeve për konkursin për nivelin e parë të tekstit të përbashkët për diasporën në datë 4 Maj 2020;
7. Përfundimin e vlerësimit të aplikimeve për nivelin e parë të tekstit të përbashkët për diasporën brenda datës 1 Qershor 2020;
8. Periudha e ankimit nga aplikantët nga 1 deri më 15 qershor 2020;
9. Shpallja përfundimtare e tekstit fitues për nivelin e parë të tekstit të përbashkët për diasporën brenda datës 18 Qershor 2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Z. Nuhi Gashi	Kryetar
Znj. Etleva Kondi	Nënkryetare
Z. Arbër Salihi	Anëtar
Znj. Shqipe Gashi-Ramadani	Anëtare
Z. Isni Kryeziu	Anëtar
Z. Valmir Gashi	Anëtar
Znj. Erida Koleci	Anëtare
Znj. Majlinda Hala	Anëtare
Znj. Evis Mastori	Anëtare
Znj. Anila Ferizaj	Anëtare

SHTOJCA 2

TREGUESI I LEGJISLACIONIT PËR VITIN 2018-2019

Duke qenë se ky është raporti i parë vjetor i Qendrës së Botimeve për Diasporën, në këtë “tregues” janë përfshirë edhe aktet ligjore dhe nën ligjore të miratuara në vitin 2019 dhe 2019 të cilat kanë të bëjnë me fushën e saj të përgjegjësisë. Aktet ligjore dhe nënligjore janë si më poshtë:

- VENDIM Nr.469, datë 26.07.2018, PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN
- URDHËR Nr.76, datë 15.04.2019, PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN
- Urdhri per miratimin e rregullores
VENDIMET E KËSHILLIT KOORDINUES TË BOTIMEVE PËR DIASPORËN
- VENDIM Nr.104, datë 28.02.2019, PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT SHTETËROR TË MËSUESVE TË GJUHËS SHQIPE E TË KULTURËS SHQIPTARE DHE DHËNIEN E CERTIFIKATËS PËR NXËNËSIT NË DIASPORË
- VENDIM Nr. 723, datë 11.11.2019, PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 492, DATË 10. 07. 2019 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E ÇMIMEVE DHE KATEGORIVE QË PËRFITOJNË FALAS TEKSTET E BOTUARA NGA QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN PËR VITIN SHKOLLOR 2019 - 2020
- VENDIM Nr.492, datë 10.07.2019, PËR MIRATIMIN E ÇMIMEVE DHE KATEGORIVE QË PËRFITOJNË FALAS TEKSTET E BOTUARA NGA QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN PËR VITIN SHKOLLOR 2019 - 2020
- VENDIM Nr.443, datë 26.06.2019, PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT MËSIMOR DHE PËRZGJEDHJEN E ARSIMTARËVE NË DIASPORË

